

N° 48/2022

Dt. 26.09.2022

TUBIMI REGJIONAL PEJË



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

Reagim I Odës së Avokatëve të Kosovës – Dega Regjionale në Pejë

26.09.2022– Dega Regjionale e Odës së Avokatëve të Kosovës në Pejë shprehë shqetësimin serioz me rastin e ftesës së bërë për avokatin Dritëro Kollcaku nga Peja për tu dëgjuar në cilësi të dyshuarit nga Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, si i dyshuar për veprë penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale të Fajdes nga neni 331 par.3 të KPRK-së dhe Detyrimi nga neni 328 të KPRK-së lidhur me nenin 33 të KPRK-së e që dyshohet që e ka kryer gjatë përfaqësimit të klientit të tij.

Ky rast për ne avokatët është i paprecedentë dhe si i tillë është shqetësues të ftohet avokati si i dyshuar për veprimet që i ka kryer gjatë përfaqësimit të klientit të tij, pasi që në bazë të Ligjit për Avokatinë, avokatia është profesion i pavarur i cili merret me dhënien e ndihmës juridike për klientët dhe pavarësia e avokatit ndër të tjera realizohet përmes ushtrimit të pavarur të avokatit dhe dhënies së ndihmës juridike.

Ne si Odë e Avokatëve të Kosovës – Dega Regjionale në Pejë ju rikujtojmë edhe njëherë se avokati ka detyrim ligjor për të ofruar ndihmë juridike për palët dhe nëse eventualisht bëhet ndonjë shkelje e ndonjë të drejte të cilës do palë gjatë përfaqësimit, Oda e Avokatëve ka në kuadër të saj Zyrën e Prokurorit Disiplinor i cili merret me shkeljet e pretenduara të avokatit gjatë përfaqësimit të klientit e që mund të jetë objekt i hetimit të kësaj zyre disiplinore edhe për shkeljet që pretendojnë palët e dëmtuara.

Andaj, apelojmë që raste të tilla të mos përsëriten sepse me këtë veprim Prokuroria e Shtetit përveq se ka krijuar një rast të pazakontë, në mënyrë të drejtëpërdrejt ka cënuar sigurinë tonë juridike për të ushtruar profesionin dhe për të ofruar shërbime juridike për palët, e që si Degë Regjionale e Odës së Avokatëve të Kosovës do të bëjmë të pamundurën dhe do të përdorim të gjitha mjetet ligjore për të mos lejuar që avokati të nëpërkëmbet gjatë ushtrimit të profesionit e që këtë na garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatinë.

Me respekt;

Kryetari i Degës Regjionale të OAK-së Pejë
LL.M.Blerim Ademaj, avokat